

VENDIM
Nr.606, datë 12.9.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PARLAMENTARE NË ZONËN ZGJEDHORE NR.31, TIRANË, MË 23 SHTATOR 2007

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’i shtohet fondi 4 500 000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë, për financimin e zgjedhjeve të pjesshme parlamentare, në zonën zgjedhore nr.31, Tiranë, më 23 shtator 2007.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha